



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 1143 / 12 Prot.

Pukë, më 17/07/2026

V E N D I M

Nr. 32 Datë 17/07/2026

P Ë R

“MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TE VEPRIMIT PER BARAZINE GJINORE
2026-2030”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr.9970, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, Vendimit nr. 400, datë 30.6.2021 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, 2021-2030, dhe të planit të saj të veprimit” Ligji Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligji Nr. 125/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, Ligji Nr. 124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.10221/04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, Ligji Nr. 35/2020 “Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji Nr. 136/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, Ligji Nr.104/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji Nr. 101/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar , Ligji Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji Nr. 65/2016 “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e femijës”, Ligji Nr. 22/2018 “Për strehimin social” i ndryshuar, Ligji Nr. 75/2019 “Për rininë” i ndryshuar, Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në jetën vendore , me propozim të Kryetarit të Bashkisë ,Keshilli Bashkise:

VENDOSI:

1. Te miratoj ,Planin Vendor për Barazinë Gjimore 2026-2030, bashkangjitur këtij dokumenti
2. Per ndjekjen e zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Sektori i Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimit Social, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, sipas përkatësisë të gjitha drejtoritë dhe sektoret .
3. Ky vendim hyn në fuqi SIPAS LIGJIT 139/2015 “Per Veteqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.
4. Vendimi u shpall me dt.17.07.2026

Vota te vlefshme gjithsej 9

Vota pro 9, Vota kunder 0, Vota abstenim 0.

Sekretari

Ndriçim ASLLANAJ



Kryetari

Gjon GJOKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 5421 prot.

Shkodër më 22.07.2026

Lënda: Mbi Vendimin nr.32, datë 17.07.2026 të Këshillit Bashkiak Pukë.

KËSHILLI BASHKIAK PUKË

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", të ndryshuar, neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 21, datë 05.02.2025 "Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 39, datë 20.02.2025 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligji nr.9970 datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri", ligji Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", VKM nr.400 datë 30.06.2021 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030 dhe planit të saj të veprimit, ligji nr.9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar, ligjin Nr.221/2010 Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar, ligji nr. 7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, ligji nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, ligji nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i përditësuar, ligji Nr.121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", ligji nr. 37/2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur", ligji nr.7905, datë 21.03.1995 "Kodi i Procedurës Penale" i ndryshuar, ligji nr.22/2018 "Për strehimin social", ligji nr.75/2019 "Për rininë" i ndryshuar, Karta Evropiane për barazi të Grave dhe Burrave në jetën vendore", shkresës së KB nr. 1132/4 datë 20.07.2026 dhe shkresës së KB nr. 1132/5 datë 21.07.2026 të këshillit të bashkisë Pukë, shqyrtoi vendimin nr. 32 datë 17.07.2026 "Për miratimin e planit vendor të veprimit për barazinë gjinore 2026-2030 për bashkinë Pukë".
Pas shqyrtimit, Prefekti autorizon procedim të planit vendor për barazinë gjinore.
Ju sjell në vëmendje respektimin e afatit ligjor mbi procesin e konsultimit publik referuar nenit 15 të ligjit Nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" i ndryshuar.
Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,


PREFEKTI
HOLTA DUDA
